



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria Për Bujqësi, Pylltari Dhe Zhvillim Rural

08 Nr. ____ /2025


Dt. ____/____/2025

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Deçanit, në kuadër të projekteve për zhvillim të bujqësisë dhe përkrahjen e fermerëve publikon këtë:

THIRRJE PËR APLIKIM

Në projektin për mbështetje të Fermerëve Deçanas me Mekanizëm Bujqësor:

1. Frezë 1.8
2. Motokultivator 4.4 KW
3. Shpërndarëse e Plehut 500 Kg
4. Centrifuga për Bletarë
5. Koshere për Bletarë
6. Makina Mjelëse



➤ Kriteret e përgjithshme për aplikim:

1. Fermeri duhet të jetë qytetar i Komunës së Deçanit;
2. Të posedoj tokë të punueshme me kultura bujqësore:
 - Fermeri që aplikon për **Frezë 1.8** duhet të ketë në pronësi(ose me qera për 3 vite) së paku 1ha tokë të punueshme(kultura lavërtare, perimtare etj). Nëse është aplikues i Subvencioneve/Pagesave Direkte (Të merret Dëshmia e aplikimit);
 - Fermeri që aplikon për **Shpërndarëse të plehut** duhet të ketë në pronësi(ose me qera për 3 vite) së paku 1ha tokë të punueshme(kultura lavërtare, perimtare etj). Nëse është aplikues i Subvencioneve/Pagesave Direkte (Të merret Dëshmia e aplikimit);
 - Fermeri që aplikon për **Frezë 1.8** dhe **Shpërndarëse të Plehut** duhet që të posedoj Traktor si mekanizëm përkatës për përdorimin e këtyre pajisjeve(Foto të Traktorit që posedon);
 - Fermeri që aplikon për **Motokultivator** duhet të ketë në pronësi(ose me qera për 3 vite) së paku 0.50 ha me perime ose kultura lavërtarë, pemtare etj;
 - Fermeri(ose dikush nga bashkësia e ngushtë familjare) që ka përfutur **Motokultivator** nga Komuna e Deçanit në **5 vitet e fundit** nuk kanë të drejt aplikimi për Motokultivator në kuadër të kësaj thirrje;

3. Kriteret për bletarë:

- Bletari që aplikon për **2 koshere** duhet të ketë minimum 3 shoqëri me bletë;
 - Bletari që aplikon për **3 koshere** duhet të ketë minimum 10 shoqëri me bletë;
 - Bletari që aplikon për **4 koshere** duhet të ketë minimum 30 shoqëri me bletë;
 - Bletari që aplikon për **Centrifugë me 4 Rama** duhet të ketë minimum 30 shoqëri me bletë;
4. Fermeri që aplikon për **Makinë mjelëse** duhet të posedojë 1-4 Lopë Qumështore;
 5. Të jetë i/e gatshëm të participojë me 20% të vlerës së përgjithshme të mekanizmit;
 6. Fermeri ka të drejt të aplikoj vetëm për një nga mekanizmat bujqësor;
 7. Nuk kanë të drejtë aplikimi më shumë se një anëtarë nga bashkësia e ngushtë familjare;
 8. Fermeri që nuk posedon pronë bujqësore të mjaftueshme por pronën e ka të marrë me qera obligohet që të sjellë kontratën(të noterizuar) të pronës së marrë me qera;
 9. Përparësi do të kenë fermerët që nuk kanë përfituar më parë nga Komuna: Mekanizëm Bujqësorë, Lopë Qumështore ose Serra;
 10. Përparësi në kushte të barabarta do të kenë edhe: Fermerët që pronën bujqësore e kanë në emër të tyre, Fermeret Gra, Familjet me kushte të dobëta ekonomike, Familjet me fëmijë jetim, Nënata vetë ushqyese, rastet sociale;
 11. Përfituesit nuk kanë të drejtë të shesin apo tjetërsojnë pajisjen(Mekanizmin e përfituar) për pesë(5) vitet pasuese.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

1. Letërnjoftimi Kopje;
2. Fleta poseduese(në emër të fermerit aplikues ose e familjarit të ngushtë e dëshmuar me vijën e gjakut);
3. Fleta poseduese dhe kontratën e noterizuar për fermerët për pronën bujqësore të marrë me qera;
4. Për Bletarin me mbi 30 shoqëri me bletë/ Dëshmia për Aplikim për Pagesa Direkte. Për Bletarin nën 30 shoqëri/Dëshmia e vendndodhjes së koshereve(me Foto);
5. Vërtetimi dhe Deklarata e Veterinarit mbi Pronësinë e Lopëve Qumështore;
6. Aplikacioni i plotësuar nga fermeri aplikues;
7. Certifikata e bashkësisë familjare;
8. Numri Identifikues i Fermerit të Regjistruar NIF

Vërejtje:

- Nëse komisioni e parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, aplikuesi(fermeri) është i obliguar t'i sjell ato në afatin e caktuar, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfitues i Mekanizmit;
- Dokumentet e pakompletuara dhe dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk shqyrtohen dhe eliminohen nga aplikimi.

Afati për aplikim është nga 28 / 07/2025 deri me 15 / 08/2025 në ora 16:00.

Aplikimi bëhet në zyrët e Drejtorisë së Bujqësisë nr: 34 dhe 35, në katin e tretë në objektin e Komunës së Deçanit.

Drejtori i DBPZHR-së në Komunën e Deçanit

RIFAT STOJKAJ

